



UNMIK/REG/2005/1  
13 janar 2005

---

RREGULLORE NR. 2005/1

MBI SHPALLJEN E LIGJIT PËR ORDINANCAT PRIVATE TË SHËNDETËSISË  
TË MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me nenet 9.1.44 dhe 9.1.45 të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9),

Duke marrë parasysh komunikatën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës të datës 21 tetor 2004 lidhur me Ligjin nr.2004/50 për ordinancat private të shëndetësisë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 shtator 2004,

Duke filluar nga data e nënshkrimit të Ligjit për ordinancat private të shëndetësisë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 2004/50) të bashkëngjitur në këtë Rregullore, me anë të kësaj shpall ndryshimet si në vijim:

- (a) Fjala “qytetarët” zëvendësohet në tërë tekstin e Ligjit me fjalën “banorët”;
- (b) Neni 5.1 (c) ndryshohet për t’iu referuar Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e banorëve të Kosovës lidhur me sistemin e kujdesit shëndetësor, të shpallur me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2004/47 të datës 19 nëntor 2004;
- (c) Neni 5.2 ku bëhet referenca në nenin 45 të Ligjit për shëndetësi të Kosovës të shpallur më 20 gusht 2004 është i pasaktë dhe duhet të zëvendësohet me referencën në nenin 46 të të njëjtit Ligj dhe
- (d) Formulimi “Dispozitat disiplinore dhe penale” në titullin dhe në paragrafin e parë të nenit 28 zëvendësohet me “Sanksionet administrative”.

Këto ndryshime futen në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

Nënshkruar më 13 janar 2005.

Søren Jessen-Petersen  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm